FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 35 — 18 mars — 2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 138, datë 20.2.2013	Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2014 – 2016	1415
Vendim i KM nr. 142, datë 6.2.2013	Për një shtesë në vendimin nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve", të ndryshuar.....	1423
Vendim i KM nr. 143, datë 13.2.2013	Për disa shtesa në vendimin nr.205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", të ndryshuar	1423
Vendim i KM nr. 144, datë 20.2.2013	Për pjesëmarrjen e një ekipi këshillues ushtarak (MAT-A) të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin ushtarak "ISAF", në Afganistan	1425
Vendim i KM nr. 145, datë 20.2.2013	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues në shtabin "EUFOR", në kuadër të operacionit ushtarak "ALTHEA", të Bashkimit Europian, në Bosnjë – Hercegovinë	1426
Vendim i KM nr. 146, datë 20.2.2013	Për kalimin e pasurisë së ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, të Bashkisë Tiranë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave dhe për një ndryshim në vendimin nr. 143, datë 18.1.2012 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës paraprake (pjesa e parë+pjesa e dytë) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tiranë, të qarkut të Tiranës"	1428
Vendim i KM nr. 147, datë 20.2.2013	Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.....	1434

Vendim i KM nr. 150, datë 27.2.2013	Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë	1443
Vendim i KM nr. 152, datë 27.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Shëngjon" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1446
Vendim i KM nr. 153, datë 27.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Kryezi 3" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1447
Vendim i KM nr. 154, datë 27.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Ballenjë" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	1447
Vendim i KM nr. 157, datë 27.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të shërbimit të monitorimit dhe fiskalizimit të lojërave të fatit.....	1448
Vendim i KM nr. 159, datë 27.2.2013	Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Dardhas, z. Aleksandër Çela	1448
Vendim i KM nr. 162, datë 27.2.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të shtetases Manushaqe Stana	1449
Vendim i KM nr. 163, datë 27.2.2013	Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr.396, datë 31.3.2005 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kufijve dhe rregullores së administrimit të parqeve arkeologjike të Shkodrës, Lezhës, Apolonisë, Bylisit, Amantias, Orikumit, Antigonesë, Finiqit dhe Butrintit".....	1449
Vendim i KKRT nr. 55, datë 20.2.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor "Club FM".....	1450
Vendim i KKRT nr. 56, datë 20.2.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së personit fizik Gazmend Vogli, licencuar për subjektin televiziv privat vendor "TV Klaudiana".....	1450
	Kërkesë për deklarimin e vërtetimit të faktit juridik të vdekjes për shtetasin Hajredin Hallulli	1452
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Tatjana Hazizaj	1452

VENDIM
Nr. 138, datë 20.2.2013

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, 2014 - 2016

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 23 e 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm, 2014 - 2016, sipas lidhjes nr. 1 "Tavanet e ministrive dhe institucioneve buxhetore", që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

"Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2014-2016"

Proçesi i përgatitjes së buxhetit afatmesëm si hap të parë të tij, në vijim të miratimit të kalendarit të menaxhimit të shpenzimeve publike me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr.909, datë 19.12.2012, kërkon vlerësimin dhe parashikimin makroekonomik dhe fiskal për një periudhë 3 vjecare. Mbi këtë bazë dhe në zbatim të nenit 23, të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republiken e Shqiperise" dhe te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.73 date 23.01.2013 "Per miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal per periudhen 2014-2016", Ministria e Financave ka pergatitur shperndarjen e burimeve te buxhetit te shtetit per periudhen 2014-2016, per çdo institucion te qeverisjes qendrore dhe fondet speciale te tyre. Duke qëndruar brenda kontureve të parashikimeve të treguesve makroekonomik dhe të të ardhurave për tre vitet në vijim te miratuara me vendimin e sipercituar, ne lidhjen nr.1 te ketij projektvendimi paraqiten te detajuara shpenzimet ne total sipas zerave te buxhetit per cdo njesi te qeverisjes qendrore per periudhen 2014-2016.

Me poshte jepen detaje me te hollesishme lidhur me parashikimin e zerave specifike te shpenzimeve publike per periudhen 2014-2016:

Politika e Pagave per periudhen 2014-2016 eshte hartuar ne baze te numrit aktual te punonjesve duke pasur si synim kryesor per kete periudhe rritjen e eficences dhe efektivitetit ne perdorimin e burimeve njerezore. Si rrjedhoje e kesaj politike te kujdesshme te pagave, fondi total i personelit parashikohet te ulet ne terma reale nga 5% e PBB ne 2014 ne 4.8% te PBB ne 2016.

Tabela 1. Shpenzimet e personelit 2014-2016

	Buxheti 2013	P/Buxheti 2014	P/Buxheti 2015	P/Buxheti 2016
Total Shpenzimet e Personelit (mln leke)	**71,904**	**73,170**	**75,526**	**77,747**
% PBB	5.0%	5.0%	4.9%	4.8%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	17.6%	17.8%	17.8%	17.4%
Paga + Sigurime Shoqerore (mln leke)	**70,904**	**73,170**	**75,526**	**77,747**
% PBB	4.9%	5.0%	4.9%	4.8%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	17.3%	17.8%	17.8%	17.4%
Politika te reja pagash (mln leke)	**1,000**	**0**	**0**	**0**
% PBB	0.1%	0.0%	0.0%	0.0%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	0.2%	0.0%	0.0%	0.0%

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes per vitet 2014-2016 jane parashikuar me nje rritje konstante prej 3%. Keto shpenzimeve, ne vijimesi edhe te viteve te kaluara, do te vazhdojne te orientohen kryesisht ne rritjen e shpenzimeve te funksionimit dhe mirembajtjes se sektoreve prioritare te infrastruktures, arsimit, shendetesise dhe bujqesise, duke aplikuar nje norme te diferencuar rritjeje ne favor te ketyre sektoreve prioritare.

Niveli i transfertes per Institutin e Sigurimeve Shoqerore dhe Institutin e Sigurimeve te Kujdesit Shendetesor eshte rezultante e nivelit te te ardhurave qe parashikohen per keto institucione dhe nivelit te shpenzimeve per keto institucione.

Niveli i shpenzimeve per *ISSH* parashikohet te rritet nga 94.3 miliard leke ne 2013 ne 110.7 miliard leke ne 2016. Kjo reflekton dhe politiken e rritjes konstante te pensioneve ne nivelin mesatar prej 3-5% pergjate periudhes 2014-2016.

Ndersa, shpenzimet e *ISKSH* jane parashikuar te kapin nivelin 33.6 miliard leke ne 2016, nga 30.8 miliard leke te planifikuara ne 2013.

Per sa i perket shpenzimeve per *Kompensimin ne vlere te ish-pronareve*, duke filluar nga viti 2010 ato jane subjekt i reformes qe konsiston ne cilesimin e tyre si Fond Special, me te gjitha karakteristikat e tij i financuar pjeserisht nga te ardhurat e veta dhe nga transferta e buxhetit te shtetit. Ecuria e shpenzimeve per kete ze jepet ne Tabelen 2 me poshte.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve speciale te ISSH, ISKSH dhe Kompensim ne Vlere i ish-Pronareve per periudhen 2014-2016

	Buxheti 2013	P/Buxheti 2014	P/Buxheti 2015	P/Buxheti 2016
Sigurime Shoqerore (mln leke)	**94,314**	**99,501**	**104,974**	**110,747**
% PBB	6.6%	6.8%	6.8%	6.9%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	23.0%	24.2%	24.7%	24.8%
Sigurime Shendetesore (mln leke)	**30,843**	**31,665**	**32,615**	**33,594**
% PBB	2.2%	2.2%	2.1%	2.1%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	7.5%	7.7%	7.7%	7.5%
Fondi per rritjen e Pensioneve (mln leke)	**1,500**	**1,500**	**1,500**	**1,500**
% PBB	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	0.4%	0.4%	0.4%	0.3%
Kompensimi i ish-pronareve (mln leke)	**1,800**	**1,300**	**1,300**	**1,300**
% PBB	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
% ndaj totalit te shpenzimeve buxhetore	0.4%	0.3%	0.3%	0.3%

Shpenzimet për subvencione janë parashikuar duke u bazuar në politiken ekzistuese të subvencioneve dhe në politikat për reduktimin e tyre të metejshëm. Ne reflektim te kesaj politike, ato parashikohen qe per te periudhen 2014-2016 te ulen nga 0.11% e PBB-se ne 0.09% te PBB-se (Figura 2).

Figura 2. Shpenzime per Subvencione per periudhen 2014-2016



Shpenzimet për pagesën e ndihmës ekonomike dhe paaftësise Shpenzimet per pagesen e ndihmes ekonomike dhe paaftesise parashikohen te rriten nga 17.4 miliarde ne vitin 2013 ne 19 miliarde leke ne 2016 (Tabela 3). Reforma ne fushen e mbrojtjes sociale synon te përmirësojë barazinë, efikasitetin, transparencën dhe efektivitetin e përdorimit të burimeve për uljen e varfërisë. Këto reforma për Ndihmën Ekonomike gjithashtu mbështesin politikat që forcojnë mekanizmat për shpërndarjen e fondeve dhe përzgjedhjen e përfitueve në programin kryesor të asistencës sociale; shtojne stimuj për investimin në

kapitalin njerëzor përmes ofrimit të një pagese sociale shtesë të lidhur me regjistrimin dhe frekuentimin në shkollë për familjet që kanë fëmijë në moshë shkollore; hapin procesin për krijimin e një regjistri të unifikuar të përfituesve të programeve të asistencës sociale; dhe ndryshojnë formulat e indeksimit të programit të pagesave të invaliditetit.

Tabela 3. Shpenzimet per mbeshtetje sociale 2014-2016

	Buxheti 2013	P/Buxheti 2014	P/Buxheti 2015	P/Buxheti 2016
Shpenzime te tjera (mln leke)	**21,400**	**20,700**	**21,500**	**22,300**
% PBB	1.5%	1.4%	1.4%	1.4%
Pagesa e papunesise (mln leke)	**1,000**	**1,000**	**1,100**	**1,100**
% PBB	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
NE dhe paaftesia (mln leke)	**17,400**	**17,900**	**18,400**	**19,000**
% PBB	1.2%	1.2%	1.2%	1.2%
Komp. per ish te Pernd. Pol. (mln leke)	**3,000**	**1,800**	**2,000**	**2,200**
% PBB	0.2%	0.1%	0.1%	0.1%

Niveli i fondit rezerve te Keshillit te Ministrave dhe Kontigjences per Ruajtjen e Deficitit per periudhen 2014-2016 eshte parashikuar te rritet gradualisht duke rezultuar ne 13 miliard leke ne 2016. Rritja graduale e shpenzimeve i dedikohet kryesisht zerit Kontigjence per ruajtjen e deficitit, gje qe reflekton situaten buxhetore ne risk si pasoje e efekteve negative te krizes financiare globale.

Shpenzimet kapitale për periudhen 2014-2016 parashikohen te luhaten ne nivelin mesatar nga 3.5%-3.9% te PBB (Figura 3 dhe 4). Gjithashtu, ne prioritizimin e listes se investimeve do te vazhdojne te perzgjidhen ato te cilat jane vazhdim i projekteve te meparshme, si edhe investimet qe cilesohen strategjike per zhvillimin ekonomik dhe social te vendit dhe ne perputhje me programin e qeverise. Njekohesisht, shpenzimet kapitale si me financim te brendshem ashtu edhe te huaj do te vazhdojne te perqendrohen në sektorët prioritarë të qeverisë si: infrastruktura, arsimi, shëndetësia, bujqësia e zhvillimi rural.

Figura 3. Investimet Publike per periudhen 2014-2016, ne milion leke.



Figura 4. Investimet Publike per periudhen 2014-2016, ne % te PBB



Duke Ju falenderuar per bashkepunimin, bashkelidhur gjeni lidhjen nr.1, ku paraqiten Tavanet Pergatitore te shpenzimeve te PBA 2014-2016, sipas institucioneve buxhetore perkatese.

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, ne milion Leke

		viti 2014						viti 2015						viti 2016					
		600-601	602-606	230-231				600-601	602-606	230-231				600-601	602-606	230-231			
	Emertimi i Institucionit Buxhetor	Paga+Sig.shoq.	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig.shoq.	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig.shoq.	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali
1	Presidenca	95	65	5			165	98	66	5			169	101	69	6			176
2	Kuvendi	515	345	5			865	530	350	5			885	546	365	6			918
3	Keshilli Ministrave	180	245	5			430	186	250	5			441	191	261	6			458
4	Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes	814	292	200	1,000		2,306	838	298	200	1,000		2,334	863	309	200	1,000		2,372
5	Ministria e Bujqesise, Ushqim. dhe Mbrojt. se Konsum.	1,751	2,258	500	2,000		6,509	1,804	2,280	600	2,000		6,684	1,858	2,380	600	2,500		7,338
6	Ministria e Puneve Publike, Transport. dhe Telekomunik.	911	3,108	5,500	33,000		42,519	938	3,150	6,028	29,016		39,130	966	3,289	5,828	31,738		41,821
10	Ministria e Financave	3,502	1,210	80	900	1,930	7,622	3,607	1,220	100	700	1,950	7,577	3,715	1,274	94	700	2,000	7,783
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	29,458	7,135	900	2,000		39,493	30,342	7,180	900	2,000		40,422	31,252	7,496	900	2,000		41,648
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	983	616	10			1,609	1,012	629	10			1,651	1,042	658	6			1,705
13	Ministria e Shendetesise	2,732	1,973	380	1,000	24,675	30,739	2,814	2,000	400	1,400	25,302	31,915	2,898	2,088	500	1,700	25,928	33,114
14	Ministria e Drejtesise	3,682	960	80	1,000	300	6,022	3,793	965	80	300	400	5,538	3,907	1,007	106	300	600	5,920
15	Ministria e Puneve te Jashtme	886	1,268	10			2,164	912	1,280	10			2,202	940	1,336	6			2,282
16	Ministria e Brendshme	12,349	3,431	100	400		16,280	12,719	3,450	100	400		16,669	13,101	3,602	94	500		17,297
17	Ministria e Mbrojtjes	6,894	4,964	300		4,600	16,757	7,100	4,980	400		4,650	17,130	7,314	5,195	400	0	4,700	17,609
18	Sherbimi Informativ Shteteror	979	330	10			1,319	1,008	337	10			1,354	1,038	351	6			1,395
19	Drejtoria e Radio Televizionit	0	355	0			355	0	355	0			355	0	360	6			366
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	133	38	5			176	137	39	5			181	141	40	6			187
22	Akademia e Shkences	33	52	1			86	34	53	1			88	35	55	1			92
24	Kontrolli Larte i Shtetit	232	60	4			296	239	61	4			304	246	64	6			316
25	Ministria e Punes, Cesht. Sociale dhe Shanseve te Bara.	1,159	21,300	200	500	37,983	61,142	1,193	22,120	200	500	40,845	64,858	1,229	23,000	200	500	43,745	68,674
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	948	263	60	500		1,771	978	268	100	500		1,844	1,005	280	28	500		1,813
28	Prokuroria e Pergjithshme	984	320	10			1,314	1,013	326	10			1,350	1,044	341	6			1,390
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,378	305	10			1,693	1,419	311	10			1,741	1,482	325	6			1,793
30	Gjykata Kushtetuese	78	30	1			109	80	31	1			112	83	32	2			117
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	78	15	1			94	80	16	1			97	83	17	2			102
40	Partite Politike	0	200	0			200	0	200	0			200	0	200	0			200
50	Instituti Statistikes	361	148	3			512	371	150	3			524	382	157	6			545
55	Shkolla e Magjistratures	27	30	1			58	28	31	1			59	29	32	2			63
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,000	4,939		5,939	0	0	1,000	4,500		5,500	0	0	1,000	5,637		6,637
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	9	98	2			107	9	98	2			109	9	103	2			114
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	60	30	2			92	62	31	2			95	64	32	5			101
66	Avokati i Popullit	75	18	2			95	77	19	2			98	80	20	2			102
67	Komisioni i Sherbimit Civil	33	11	2			46	34	12	2			48	35	13	2			50
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	74	20	3			97	76	620	3			699	79	21	4			103
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	63	28	3			94	65	29	3			96	67	30	5			101
77	Autoriteti i Konkurences	49	10	2			61	51	11	2			64	52	12	6			70
78	Ministria e Integrimit	83	52	5	250		390	88	53	5	250		394	89	55	6	250		400
82	Keshilli Kombetar Kontabilitetit	7	6	1			14	7	7	1			15	8	8	2			18
86	Avokati i Prokurimeve		0	0			0		0	0			0		0	0			0
87	Institucione te tjera Qeveritare	187	265	60	0		512	193	270	60	0		523	199	282	56	200		737
88	Mbeshtetje per shoqerine civile	13	107	1			122	13	108	1			122	14	113	1			128
89	Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	34	11	1			46	35	12	1			48	36	13	1			50
91	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	8	1			36	28	9	1			38	29	10	1			40
92	Instituti i Studimit te Krimeve te Komunizmit	17	12	1			30	18	13	1			32	18	14	1			33

Lidhja nr.1: Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, ne milion Leke

		viti 2014						viti 2015						viti 2016					
		600-601	602-606	230-231				600-601	602-606	230-231				600-601	602-606	230-231			
	Emertimi i Institucionit Buxhetor	Paga+Sig.shoq.	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig.shoq	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali	Paga+Sig.shoq	Te tjera Korente	Investime/ brendshme	Investime/ huaja	Transferime per Fondet Speciale ISSH +ISKSH+KP	Totali
1	Presidenca	95	65	5			165	98	66	5			169	101	69	6			176
2	Kuvendi	515	345	5			865	530	350	5			885	546	365	6			918
3	Keshilli Ministrave	180	245	5			430	186	250	5			441	191	261	6			458
4	Ministria e Ekonomise, Treglise dhe Energjitikes	814	292	200	1,000		2,306	838	296	200	1,000		2,334	863	309	200	1,000		2,372
5	Ministria e Bujqesise, Ushqim. dhe Mbrojt. se Konsum.	1,751	2,258	500	2,000		6,509	1,804	2,280	600	2,000		6,684	1,858	2,380	600	2,500		7,338
6	Ministria e Puneve Publike, Transport. dhe Telekomunik.	911	3,108	5,500	33,000		42,519	938	3,150	6,026	29,016		39,130	966	3,289	5,628	31,738		41,621
10	Ministria e Financave	3,502	1,210	80	900	1,930	7,622	3,607	1,220	100	700	1,950	7,577	3,715	1,274	94	700	2,000	7,783
11	Ministria e Arsimit dhe Shkences	29,458	7,135	900	2,000		39,493	30,342	7,180	900	2,000		40,422	31,252	7,496	900	2,000		41,648
12	Ministria e Turizmit, Kultures, Rinise dhe Sporteve	983	616	10			1,609	1,012	629	10			1,651	1,042	656	6			1,705
13	Ministria e Shendetesise	2,732	1,973	360	1,000	24,675	30,739	2,814	2,000	400	1,400	25,302	31,915	2,898	2,088	500	1,700	25,928	33,114
14	Ministria e Drejtesise	3,682	960	80	1,000	300	6,022	3,793	965	80	300	400	5,538	3,907	1,007	106	300	600	5,920
15	Ministria e Puneve te Jashtme	886	1,268	10			2,164	912	1,280	10			2,202	940	1,336	6			2,282
16	Ministria e Brendshme	12,349	3,431	100	400		16,280	12,719	3,450	100	400		16,669	13,101	3,602	94	500		17,297
17	Ministria e Mbrojtjes	5,894	4,964	300		4,600	16,757	7,100	4,980	400		4,650	17,130	7,314	5,195	400	0	4,700	17,609
18	Sherbimi Informativ Shteteror	979	330	10			1,319	1,008	337	10			1,354	1,038	351	6			1,395
19	Drejtoria e Radio Televizionit	0	355	0			355	0	355	0			355	0	360	6			366
20	Drejtoria e Pergjithshme e Arkivave	133	38	5			176	137	39	5			181	141	40	6			187
22	Akademia e Shkences	33	52	1			86	34	53	1			88	35	55	1			92
24	Kontrolli Larte i Shtetit	232	60	4			296	239	61	4			304	246	64	6			316
25	Ministria e Punes, Cesht. Sociale dhe Shanseve te Bara.	1,159	21,300	200	500	37,983	61,142	1,193	22,120	200	500	40,845	64,858	1,229	23,000	200	500	43,745	68,674
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit te Ujrave	948	263	60	500		1,771	976	268	100	500		1,844	1,005	280	28	500		1,813
28	Prokuroria e Pergjithshme	984	320	10			1,314	1,013	326	10			1,350	1,044	341	6			1,390
29	Zyra e Administrimit te Buxhetit Gjyqesor	1,378	305	10			1,693	1,419	311	10			1,741	1,462	325	6			1,793
30	Gjykata Kushtetuese	78	30	1			109	80	31	1			112	83	32	2			117
31	Agjensia Telegrafike Shqiptare	78	15	1			94	80	16	1			97	83	17	2			102
40	Partite Politike	0	200	0			200	0	200	0			200	0	200	0			200
50	Instituti Statistikes	361	148	3			512	371	150	3			524	382	157	6			545
55	Shkolla e Magjistratures	27	30	1			58	28	31	1			59	29	32	2			63
56	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,000	4,939		5,939	0	0	1,000	4,500		5,500	0	0	1,000	5,637		6,637
57	Qendra Kombetare e Kinematografise	9	96	2			107	9	98	2			109	9	103	2			114
63	Keshilli i Larte i Drejtesise	60	30	2			92	62	31	2			95	64	32	5			101
66	Avokati i Popullit	75	18	2			95	77	19	2			98	80	20	2			102
67	Komisioni i Sherbimit Civil	33	11	2			46	34	12	2			48	35	13	2			50
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	74	20	3			97	76	620	3			699	79	21	4			103
76	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	63	28	3			94	65	29	3			96	67	30	5			101
77	Autoriteti i Konkurences	49	10	2			61	51	11	2			64	52	12	6			70
78	Ministria e Integrimit	83	52	5	250		390	86	53	5	250		394	89	55	6	250		400
82	Keshilli Kombetar Kontabilitetit	7	6	1			14	7	7	1			15	8	8	2			18
86	Avokati i Prokurimeve		0	0			0		0	0			0		0	0			0
87	Institucione te tjera Qeveritare	187	265	60	0		512	193	270	60	0		523	199	282	56	200		737
88	Mbeshtetje per shoqerine civile	13	107	1			122	13	108	1			122	14	113	1			128
89	Komisioneri per Mbrojtjen e te Dhenave Personale	34	11	1			46	35	12	1			48	36	13	1			50
91	Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi	27	8	1			36	28	9	1			38	29	10	1			40
92	Instituti i Studimit te Krimeve te Komunizmit	17	12	1			30	18	13	1			32	18	14	1			33

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE QBZ

Tavanet e Ministrive dhe Institucioneve Buxhetore, ne l

	Emertimi i Institucionit Buxhetor	viti 2017					viti 2018					viti 2019					viti 2020				
		600-601	602-606	230-231			600-601	602-606	230-231			600-601	602-606	230-231			600-601	602-606	230-231		
		Page/Shpenz	Tatim Kombe	Investime/ Shoqerim	Investime/ Huaja	Transferta per Fonde Speciale Sociale ISSH+ISKSH+IKF	Totali	Page/Shpenz	Tatim Kombe	Investime/ Shoqerim	Investime/ Huaja	Tra sferta per Fondi Special Shoqeror ISSH +ISKSH+IKF	Totali	Page/Shpenz	Tatim Kombe	Investime/ Shoqerim	Investime/ Huaja	Transferta per Fondet Speciale Shoqerore ISSH +ISKSH+IKF	Totali	Page/Shpenz	Tatim Kombe	Investime/ Shoqerim	Investime/ Huaja	Transferta per Fondet Speciale Shoqerore ISSH +ISKSH+IKF	Totali
1.	Presidenca	154	70	6			179	107	75	16			198	110	75	25			211	113	85	30			228
2.	Kuvendi	553	388	6			937	580	380	16			891	597	396	25			1,012	615	402	30			1,047
3.	Kryeministri	191	283	8			466	223	278	16			494	209	278	25			513	215	300	30			545
4.	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës	886	311	200	1,000		2,481	916	325	632	1,000		2,874	943	330	900	1,000		3,173	972	345	1,026	875		3,192
5.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit, Blegtorisë dhe Mjedisit së Kohëve	1,913	2,399	600	2,900		7,813	1,877	2,515	948	2,700		8,133	2,030	2,541	1,200	2,890		8,671	2,091	2,637	1,815	3,000		9,544
6.	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	998	3,315	3,978	29,270		37,562	1,028	3,485	948	24,812		33,316	1,056	3,510	14,377	19,357		38,300	1,087	3,611	20,942	13,450		39,150
7.	Ministria e Financave	3,827	5,284	84	700	2,050	7,955	3,940	1,245	253	700	2,100	8,340	4,060	1,256	407	700	2,150	8,576	4,182	1,422	494	730	2,200	8,988
8.	Ministria e Arsimit, Sportit, Kulturës, Rinisë dhe Shoqërisë	32,192	7,658	996	2,000		42,845	32,155	7,918	1,570	2,000		44,644	34,150	8,300	2,000	2,000		46,450	35,174	9,367	3,900	2,000		49,442
9.	Ministria e Drejtësisë	1,074	562	8			1,141	1,100	693	16			1,815	1,139	701	25			1,865	1,173	733	30			1,936
10.	Ministria e Shëndetësisë	2,965	2,105	905	2,200	28,557	34,347	3,075	2,296	1,023	2,500	27,174	35,978	3,167	2,226	1,000	27,792		37,667	3,263	2,331	1,990	3,500	28,417	39,471
11.	Ministria e Mbrojtjes	4,024	1,018	198	300	1,000	6,442	4,145	1,064	204	300	1,200	6,993	4,269	1,075	458	1,800		7,802	4,397	1,125	545	370	1,700	8,086
12.	Ministria e Punëve të Jashtme	966	1,347	8			2,321	997	1,412	16			2,424	1,027	1,428	25			2,479	1,058	1,452	30			2,569
13.	Ministria e Brendshme	13,484	3,631	504			17,719	13,890	3,805	253	500		18,456	14,316	3,944	407	500		19,067	14,745	4,021	494	500		19,759
14.	Ministria e Mirëqenies	7,553	3,237	400	0	4,150	17,519	7,759	5,488	1,000		4,800	19,047	7,992	5,545	1,000		4,850	19,387	8,231	5,600	2,020		4,800	20,931
15.	Shërbimi Informativ Shtetëror	1,089	354	8			1,429	1,101	371	16			1,488	1,134	375	25			1,535	1,168	392	30			1,590
16.	Drejtoria e Radio Televizionit	0	383	8			398	0	370	16			386	0	364	25			415	0	402	30			432
17.	Drejtoria e Inteligjencës e Mbrojtjes	145	41	8			192	197	43	16			208	154	44	25			223	159	45	30			235
18.	Akademia e Shkencës	38	56	1			93	37	58	3			99	38	59	5			102	39	62	6			107
19.	Kontrolli Larte i Shtetit	253	83	3			337	259	73	16			349	265	74	25			364	277	77	30			387
20.	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1,236	24,109	230	900	46,624	72,899	1,304	24,700	200	500	48,944	76,608	1,343	25,603	200	500	53,037	80,683	1,384	26,150	200	500	56,354	84,587
21.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave	1,038	232	28	800		1,948	1,007	296	74	800		2,237	1,060	299	118	850		2,317	1,134	319	142	900		2,386
22.	Prokuroria e Përgjithshme	1,075	343	6			1,424	1,107	354	16			1,487	1,140	358	25			1,534	1,175	369	30			1,574
23.	Zyra e Administrimit të Buxhetit Shtetëror	1,386	327	6			1,839	1,551	343	16			1,910	1,596	347	25			1,970	1,646	367	30			2,043
24.	Gjykata Kushtetuese	85	33	2			120	88	35	8			128	90	35	13			139	93	36	12			143
25.	Agjensia Telegrafike Shqiptare	85	18	2			105	88	19	8			113	90	20	13			123	93	21	12			126
26.	Posta Fo Jike	0	200	0			200	0	200	0			200	0	200	0			200	0	200	0			200
27.	Institut Statistikor	394	156	6			556	406	156	16			587	418	157	23			610	430	175	30			635
28.	Shkolla e Magjistraturës	25	33	2			60	30	35	8			71	31	36	13			77	32	38	12			82
29.	Fondi i Zhvillimit Shqiptar	0	0	1,000	8,500		9,500	0	0	2,088	6,500		8,588	0	0	3,000	7,000		10,000	0	0	4,090	8,000		12,090
30.	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10	104	2			116	12	109	8			129	10	110	10			131	11	115	12			138
31.	Këshilli Larte i Drejtësisë	88	33	5			126	88	35	13			136	70	36	20			126	72	40	24			136
32.	Arkivat i Përgjithshëm	82	21	2			105	85	22	8			115	87	23	10			120	90	24	12			126
33.	Komisioni i Shërbimit Civil	36	14	2			52	37	15	8			59	38	16	10			64	39	17	12			68
34.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	81	620	4			715	83	32	8			123	86	530	15			631	88	40	18			147
35.	Inspektoriati i Larte Kontrollit te Deklarimit te Pasurive	699	21	5			164	71	32	13			116	73	33	20			126	75	34	24			134
36.	Autoriteti Komunikimeve	548	132	8			728	95	14	10			63	57	115	25			198	59	16	30			105
37.	Autoriteti i Mediumeve	991	86	8	250		803	94	56	16	250		416	97	59	230			431	100	62	300	250		442
38.	Komisioni Kombëtar Kunder Korrupsionit	8	9	2			19	8	16	6			24	8	11	10			30	8	12	12			32
39.	Avokati i Popullit	0	0	0			0	0	0	0			0	0	0	0			0	0	0	0			0
40.	Institucioni për Mbrojtjen e Konsumatorit	205	264	58	200		745	211	298	150	200		860	217	300	242	200		959	224	314	288	200		1,026
41.	Akademia e Studimeve Mbrojtjes	14	114	1			129	15	119	3			137	15	120	5			140	16	126	6			148
42.	Komisioneri për Mbrojtjen e të Drejtave Parashkollore	37	14	1			52	38	15	3			56	39	16	5			60	41	17	8			66
43.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	29	11	1			41	30	12	3			45	31	13	5			49	32	14	6			52
44.	Institucioni i Kryeinspektorit të Arkivave	19	85	1			105	19	16	3			38	20	17	5			42	21	18	6			44

VENDIM
Nr. 142, datë 6.2.2013

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE TË DHËNIES SË KONCESIONEVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën "e", të pikës 1, të kreut V, të vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalisë së parë të paragrafit të dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

"Për koncesionet në autostrada, për të cilat parashikohet një vlerë investimesh mbi 50 milionë euro, vlera e sigurimit të ofertave të jetë deri në 2% të vlerës së projektit ose të shërbimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 143, datë 13.2.2013

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 205, DATË 13.4.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISPOZITAT ZBATUESE TË KODIT DOGANOR", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 49 të ligjit nr 61/2012 "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, në nenin 11, pjesa I, titulli II, të kreut 3, pas pikës 11.15 shtohen pikat 11.16 dhe 11.17, me këtë përmbajtje:

"11.16. Në raste specifike, kur nga operatori ekonomik paraqitet kërkesë për shërbime doganore që kërkojnë prezencë të vazhdueshme të punonjësve doganorë pranë ambienteve të tyre dhe në kushtet, kur për shkak të numrit të kufizuar të punonjësve, autoritetet doganore nuk mund të ushtrojnë shërbimet doganore pranë këtij operatori gjatë gjithë orarit të punës të kërkuar prej këtij të fundit, administrata doganore mund të ofrojë shërbime doganore përkundrejt pagesës.

Për këtë qëllim, pranë administratës doganore, mund të punësohet/en punonjës doganorë të rekrutuar, jashtë strukturës së miratuar për administratën doganore, me kusht që operatori ekonomik kërkues në fjalë të marrë përsipër pagesat për të gjitha shpenzimet e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi ku, pa kufizuar detyrimet e tjera ligjore, ku përfshihen paga mujore e punonjësit për gjithë periudhën e kërkuar të shërbimit, tatimi mbi të ardhurat mbi pagën, sigurimet shoqërore sipas

raporteve aktuale të kontributit, pagesën e lejes së zakonshme, pajisjen me uniformë personeli doganor, pagesën e sigurimeve shëndetësore, sipas raporteve aktuale të kontributit etj. Shpenzimet e sipërpërmendura për një punonjës të rekrutuar do të jenë të barabarta me nivelin aktual të pagesës, si dhe të kontributeve të kategorisë respektive që kërkohet për punonjësit e tjerë doganorë, të emëruar për natyrën dhe llojin e vendit të punës.

11.16.1. Operatori ekonomik i interesuar duhet të paraqesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave një kërkesë me shkrim, si dhe duhet të nënshkruajë një kontratë specifike për këtë qëllim në plotësim të kërkesave të përcaktuara në pikat 11.16 dhe 11.16.2, përmes së cilës merr përsipër pagesën për shërbimin e kërkuar.

11.16.2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me miratimin e kërkesës së operatorit ekonomik, nënshkruan kontratën me këtë të fundit për fillimin e rekrutimit të punonjësve për këtë qëllim. Kontrata duhet të jetë për një afat jo më pak se 1-vjeçar me të drejtë ripërsëritjeje. Palët mund ta zgjidhin këtë kontratë për çfarëdo arsye, duke bërë një njoftim së paku 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj. Në rast se palët në përfundim të kohës së vlefshmërisë së saj nuk kanë kontestime, atëherë kontrata do të konsiderohet si e lidhur edhe për një vit tjetër e kështu në vijimësi. Në rast të heqjes dorë nga autorizimi respektiv i autoriteteve doganore apo i Ministrisë së Financave prej operatorit ekonomik a revokimit ose në rast anulimi të këtyre të fundit, kontrata në fjalë do të konsiderohet automatikisht e zgjidhur.

11.16.3. Menjëherë me nënshkrimin e kontratës së sipërpërmendur, administrata doganore fillon procedurat e rekrutimit të punonjësit/ve sipas përcaktimeve të nenit 11, nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur dhe në vijimësi për gjithë periudhën e punësimit do të zbatohen të gjitha dispozitat ligjore e nënligjore, sipas të cilave rregullohen marrëdhëniet e punës së personelit doganor. Me përfundimin e procedurës së rekrutimit për këta punonjës, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave njofton për këtë qëllim, përveç strukturave të saj, edhe operatorin ekonomik kërkues. Administrimi i procedurave të sipërpërmendura kryhet nga drejtoria që menaxhon burimet njerëzore.

11.16.4. Në rast të kërkesës për ndërprerje apo prishje të kontratës nga operatori ekonomik, menjëherë me marrjen e kësaj të fundit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave duhet të njoftojë punonjësin e rekrutuar se do të zgjidhen marrëdhëniet e punës ose në rast se ka vende të lira pune brenda administratës doganore mundet t'i ofrohet vendi i lirë. Në rast se vendi i ri i punës i propozuar pranohet nga punonjësi i rekrutuar, atëherë ai transferohet në pozicionin e ri të punës pa iu nënshtruar procedurave të tjera të rekrutimit.

11.16.5. Me qëllim garantimin e pagesës korrekte të punonjësve të rekrutuar të gjitha shpenzimet tremujore (tërësia e pagesave të nevojshme) të sipërpërmendura do të parapaguhen (derdhen) nga operatori ekonomik i interesuar në llogarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, pranë Degës së Thesarit Tiranë, jo më vonë se data 25 e çdo tremujori, duke filluar që nga tremujori në të cilin bëhet efektive kontrata e punësimit dhe do të përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për mbulimin e shpenzimeve të parashikuara në pikën 11.16. Në rast se shpenzimet nuk parapaguhen në llogarinë e sipërpërmendur, atëherë operatori ekonomik paralajmërohet se do t'i ndërpritet menjëherë shërbimi sipas intervalit kohor të kërkuar prej tij. Nëse pagesa nuk kryhet brenda një afati 10-ditor pas afatit të pagesës së përcaktuar më lart, atëherë kontrata do të konsiderohet e zgjidhur. Çdo e ardhur e ofruar nga operatorët ekonomikë për këtë shërbim, konsiderohen si e ardhur jashtë limitit për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

11.16.6. Për të shmangur konfliktin e interesit dhe garantimin e paanësisë së shërbimit nga autoritetet doganore, punonjësit doganorë të rekrutuar, sipas procedurave të mësipërme, nuk do të jenë të vendosur pranë operatorëve ekonomikë kërkues të shërbimit, por në struktura të tjera të shërbimit doganor. Shërbimi pranë këtyre operatorëve do të mundësohet nga punonjësit doganorë, pjesë e strukturës organike të administratës doganore.

11.17. Në rastet kur operatori paraqet kërkesë për shërbime doganore apo që kërkojnë prezencë periodike të punonjësve doganorë pranë ambienteve të tyre, një apo disa herë gjatë vitit, administrata doganore mund të ofrojë shërbime doganore përkundrejt pagesës së tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave, e cila merr në konsideratë koston e plotë të këtij shërbimi. Kjo tarifë bazohet në përcaktimet e legjislacionit të punës për këtë qëllim dhe merr në konsideratë shpenzimet e transportit dhe shpenzime të tjera për kryerjen e shërbimit.".

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 144, datë 20.2.2013

PËR PJESËMARRJEN E NJË EKIPI KËSHILLUES USHTARAK (MAT-A) TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, NË OPERACIONIN USHTARAK "ISAF", NË AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të një ekipi këshillues ushtarak (MAT-A), të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Kabul, Afganistan, në Komandën Rajonale Qendrore (RC-C/Regional Command Capital), në kuadër të operacionit ushtarak "ISAF".

2. Përpara dërgimit me mision të ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) në operacionin ushtarak "ISAF" dhe gjatë tij, të zhvillohet në rajonet e zonat e operacionit misioni i rikonicionit, për njohjen e terrenit të veprimit të palëve. Kohëzgjatja e këtij misioni të jetë deri në 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe ekipi i rikonicionit të përbëhet nga 4 (katër) ushtarakë të fushave: operacione, zbulim/siguri, logjistikë dhe komunikim.

3. Misioni i ekipit këshillues ushtarak (MAT-A) është marrja në patronazh për këshillimin, trajnimin, drejtimin, mbështetjen dhe zhvillimin operacional të një batalioni të mbështetjes së luftimit të Ushtrisë Kombëtare Afgane, në Komandën Rajonale-Qendrore RC-C, operacioni "ISAF", në Kabul, Afganistan, duke vepruar dhe kryer detyra operacionale e luftarake, për krijimin e bazave për koordinim, komandim, si dhe zhvillim e mbështetje të planëzimeve në operacion, pjesëmarrje në zhvillimin e operacioneve luftarake e mbështetëse për plotësimin e misionit të Task-Forcës së Aleancës dhe Forcave Afgane të Sigurisë, në qytetin e Kabulit ose rrethinat e tij, duke kontribuar në realizimin e misionit dhe të detyrave operacionale luftarake të Komandës Rajonale-Qendrore (RC-C), operacioni "ISAF", në Kabul, Afganistan.

4. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor të vitit 2014. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 9 (nëntë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me ekipin e radhës.

5. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesit ushtarakë në përbërje të ekipit këshillues ushtarak (MAT-A), pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) mbështetje shëndetësore;

ç) shërbim telefonik, postar dhe internet;

d) transport;

dh) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

e) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

ë) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ushtarakët pjesëmarrës në ekipin e rikonicionit, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) mbështetje shëndetësore;

ç) shërbim telefonik;

d) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

dh) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

9. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 145, datë 20.2.2013

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË SHTABIN "EUFOR", NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK "ALTHEA", TË BASHKIMIT EUROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5, e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të 1 (një) përfaqësuesi ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në Sarajevë, Bosnjë-Hercegovinë, në shtabin "EUFOR", në kuadër të operacionit ushtarak "ALTHEA", të Bashkimit Europian.

2. Misioni i përfaqësuesit ushtarak, në kuadër të operacionit ushtarak "ALTHEA", është drejtimi, monitorimi, këshillimi i Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës për të gjitha çështjet në lidhje me stërvitjen kolektive, me qëllim implementimin dhe arritjen e aftësive mbrojtëse.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 2 (dy) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të përfaqësuesit të parë ushtarak në Bosnjë-Hercegovinë. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesin e radhës.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për përfaqësuesin ushtarak pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shërbimin telefonik dhe internet;

dh) transport;

e) trasportimin e individit të shkëputur të misionit për në atdhe, në rast vdekjeje ose sëmundjeje;

ë) akomodim (fjetje, ngrohje, ujë);

f) ushqim;

g) energji elektrike, ujë të pijshëm, lavanderi;

gj) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kryerjes së misionit;

h) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili do të marrë pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 146, datë 20.2.2013

PËR KALIMIN E PASURISË SË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE NR. 8380 TË BASHKISË TIRANË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR ENTIN KOMBËTAR TË BANESAVE DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 143, DATË 18.1.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE (PJESA E PARË+PJESA E DYTË) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË TIRANË TË QARKUT TË TIRANËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 pika 3, 10, 12, 13, 15/c e 16 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, të nenit 8/a të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9232, datë 13.5.2004 "Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurisë me numër rendor 402 (pjesa e parë), me emërtimin "Ish-kopshti nr. 9", ndodhur në zonën kadastrale nr. 8380, me numër pasurie 7/102, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, për Entin Kombëtar të Banesave, për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.
2. Heqjen e pronës nr. 402 (pjesa e parë), me emërtimin "Ish-kopshti nr. 9", nga lidhja nr. 1, bashkëlidhur vendimit nr. 143, datë 8.1.2012 të Këshillit të Ministrave.
3. Pas kalimit në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, ngarkohet ky ent të lidhë kontratat e privatizimit me banorët e pastrehë, përcaktuar në listat që i bashkëlidhen këtij vendimi, sipas kushteve të privatizimit, të përcaktuara në udhëzimin nr. 22, datë 12.10.2010, të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, të ndryshuar.
4. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Enti Kombëtar i Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA EMËRORE E FAMILJEVE TË STREHUARA NË KOPSHTIN NR. 9,
RRUGA "RESHIT ÇOLLAKU", TIRANË

1. Nervin Starova
2. Estref Starova
3. Eqerem Plaku
4. Xhemal Cala
5. Sokrat Shyti
6. Mina Rista
7. Fazilet Gaba
8. Adem Pirgu
9. Arben Pirgu

1. Formular për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucion i pushtetit qendror:Ministria e Brendshme
Fusha e përdorimit të pronës: godinë+truall

Nr. Rend.	**A**			**B**			**C**			
	Zona kadastrale dhe indeksi i hartës	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pronës**	**Emri i pronës adresa**	**Sip. totale e pronës**	**Nga sip totale: Sa ndërtesë (m^2)**	**Funksioni për të cilin përdoret prona**	**Institucioni/enti me përgjegjësi administrative**	**Institucioni/enti përdorues statusi juridik i përdorimit**	**Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8380 Q-11	7/102	Godinë+truall	Ish-kopshti nr. 9, Tiranë	130	789	Strehim banorësh të persekutuar politikë	Bashkia Tiranë	Bashkia Tiranë	S'ka

3KT
Shkolla 8 vjeçare
*20 vjetori
Fushë -basketbolli
Fushë-voleibolli
Fushë-voleibolli
Fushë tenisi
Tenis
Basketbolli
Çerdhe
Strehim
5KT
1KT
2KT


GARDEROB
GARDEROB
DEPO KREK
DEPO KREK
MOBILIM NE KOHEN E LOJNAVE
MOBILIM NE KOHEN E FJETHEVE
A
A'
B
C
576
418
500
538
380
871
910
1343
1104
840


SHKALLA 1:100
GRUPI III
GARDEROB
GARDEROB
DEPO KREVAT.
PERSONEL
DREJTOR
MJEK
DEPO SHTEG
DEPO KREV.
MOBILIM PER TE ARTHMEN
GRUPI I
W.C LAVABO
W.C LAVABO
per 180 m. nalteri
per 180 m. nalteri

8380
TIRANE
7/102
TR:
TD

VENDIM
Nr. 147, datë 20.2.2013

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave të organizimit dhe të funksionimit të Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor.

Neni 2
Përkufizime

Në kuptim të këtij vendimi:

1. "ASIG" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 1 i ligjit nr. 72, datë 28.6.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

2. "Autoriteti publik" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 2 i ligjit nr. 72, datë 28.6.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

3. "BIG" ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 3 i ligjit nr. 72, datë 28.6.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

4. "Ligji mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor" është ligji nr. 72, datë 28.6.2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë".

5. “Ministri” ka të njëjtin kuptim me atë të dhënë nga neni 3 paragrafi 20 i ligjit nr. 72, datë 28.6.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 3
Veprimtaria e ASIG-ut

1. Në veprimtarinë e tij, ASIG respekton parimet e përcaktuara në nenin 4 të ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. ASIG ushtron funksionet e tij që burojnë nga ligji mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

3. Në veprimtarinë e tij, ASIG zbaton kërkesat e legjislacionit në fuqi mbi mbrojtjen e të dhënave personale, mbi pronësinë intelektuale dhe mbi informimin e publikut me dokumentet zyrtare.

4. “Ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor”, sipas ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, është ministri përgjegjës për inovacionin dhe teknologjinë e informacionit e të komunikimit.

KREU II
ORGANIZIMI I AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Neni 4
Autoriteti shtetëror për informacionin gjeohapësinor

1. ASIG është organi përgjegjës për çështjet që lidhen me infrastrukturën kombëtare të të dhënave gjeohapësinore, sipas përcaktimeve të ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. ASIG organizohet dhe funksionon në bazë të ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe të këtij vendimi, si institucion publik qendror, me personalitet juridik në varësi të ministrit.

3. ASIG ka selinë në Tiranë dhe financohet nga Buxheti i Shtetit, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga veprimtaria e tij.

Neni 5
Stema dhe vula zyrtare

1. ASIG ka stemën dhe vulën zyrtare.

2. Stema përbëhet nga stema e republikës dhe shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

3. Vula e ASIG-ut ka formën dhe përmban elementet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi mbi prodhimin, administrimin, kontrollin dhe ruajtjen e vulave zyrtare. Vula e ASIG-ut përmban shënimin identifikues “Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.

4. Vula e ASIG-ut administrohet e ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6
Përbërja e ASIG-ut

1. ASIG organizohet si drejtori e përgjithshme sipas strukturave organizative të parashikuara në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

2. Strukturat organizative të ASIG-ut realizojnë kryesisht funksionet e mëposhtme:

a) Koordinimin ndërinstitucional dhe administrimin e informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë;

b) Përcaktimin e standardeve dhe rregullave uniforme.

3. Struktura dhe organika e ASIG-ut miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe pas marrjes së mendimit të ministrit përgjegjës për financat. Departamenti i Administratës Publike harton projekturdhrin dhe ia dërgon për shqyrtim dhe miratim Kryeministrit.

Neni 7

Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut

1. Drejtor i Përgjithshëm i ASIG-ut mund të zgjidhet personi që plotëson kriteret e parashikuara në nenin 8, paragrafi 3 të ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga detyra, nga ministri, në përputhje me rregullat dhe procedurat e parashikuara në legjislacionin në fuqi për emërimin, shkarkimin apo lirimin nga detyra të drejtuesve të institucioneve në varësi të ministrit.

3. Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut lirohet nga detyra kur:

a) jep dorëheqjen;

b) mbush moshën e pensionit;

c) i hiqet ose i kufizohet zotësia për të vepruar me vendim gjyqësor të formës së prerë;

d) shkarkohet nga detyra.

4. Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut shkarkohet nga detyra kur:

a) kryen shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve;

b) kryen veprimtari që krijojnë konflikt interesash;

c) merr cilësinë e të pandehurit për një vepër penale të kryer me dashje që lidhet me detyrën;

d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi.

Neni 8

Detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG-ut

Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut:

a) drejton, organizon dhe mbikëqyr veprimtarinë e institucionit dhe është përgjegjës për mirëfunksionimin e tij, si dhe përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;

b) përpunon programin vjetor për angazhimet e drejtorive dhe përcakton prioritetet në punën e tyre;

c) raporton në mënyrë periodike mbi veprimtarinë e institucionit pranë ministrit;

ç) i raporton ministrit, të paktën një herë në 3 muaj, për veprimtarinë e kryer nga ASIG, duke vënë në dukje mangësitë e mundshme ligjore dhe nevojat për ndryshime përkatëse;

d) i propozon ministrit ndërmarrjen e nismave ligjore për plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fuqi;

dh) miraton kriteret e veçanta të pozicioneve të punës të punonjësve dhe përshkrimin e vendeve të punës;

e) miraton lejet vjetore të punonjësve, si dhe kontrollon zbatimin e tyre;

ë) emëron, shkarkon dhe liron punonjësit sipas rregullave të parashikuara në dispozitat e Kodit të Punës;

f) zhvillon procedurat disiplinore ndaj punonjësve;

g) harton dhe administron buxhetin vjetor;

gj) nxjerr akte të brendshme, të detyrueshme për menaxhimin administrativ, financiar dhe burimeve njerëzore të ASIG-ut;

h) administron burimet pasurore, financiare dhe njerëzore të ASIG-ut, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Funksioni i koordinimit ndërinstitucional dhe i administrimit të informacionit gjeohapësinor

Në kuadër të koordinimit ndërinstitucional dhe të administrimit të informacionit gjeohapësinor, ASIG-u ushtron këto funksione:

a) koordinimin e veprimtarive dhe nismave lidhur me informacionin gjeohapësinor në sektorin publik dhe privat;

b) sigurimin dhe mbarëvajtjen e procesit të ngritjes dhe të përmirësimit të infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor nëpërmjet bashkëpunimit me institucionet publike dhe sektorin privat;

c) administrimin e Gjeoportalit Kombëtar;

ç) ndjekjen e procedurave përkatëse në cilësinë e sekretariatit teknik të BIG-ut;

d) zbatimin e politikës kombëtare për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;

e) mbikëqyrjen e zbatimit të kuadrit rregullator të vendosur nga ligji mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, aktet nënligjore të dala për bazë ose në zbatim të tij, si dhe në përputhje me politikat e zhvillimit të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave;

f) planifikimin dhe drejtimin e projekteve me donatorë të huaj, si dhe sigurimin e koordinimit dhe zbatimin e aktiviteteve;

g) edukimin dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në proceset që lidhen me infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor, si dhe për përhapjen e informacionit mbi të te grupet e interesit dhe publiku;

h) promovimin e investimeve në sektorin privat të të dhënave gjeohapësinore në përputhje me parimin e konkurrencës së lirë në treg;

i) përgatitjen e rekomandimeve lidhur me masat ligjore dhe organizative për ndryshimin e legjislacionit dhe përputhjen e tij me aktet komunitare;

j) çdo detyrë të veçantë të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut.

Neni 10

Funksioni i përcaktimit të standardeve dhe rregullave uniforme

Në kuadër të përcaktimit të standardeve dhe rregullave uniforme, ASIG ushtron këto funksione:

a) hartimin e rregullave dhe standardeve teknike për secilën nga temat e përcaktuara nga neni 11 i ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor;

b) hartimin dhe propozimin e kushteve dhe standardeve teknike në lidhje me krijimin, përditësimin, shkëmbimin, aksesin dhe përdorimin e grupeve të të dhënave gjeohapësinore, shërbimeve të të dhënave gjeohapësinore dhe metadatave;

c) projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e kornizës referuese gjeodezike;

ç) hartimin e rregullave dhe standardeve teknike për realizimin e ndërveprueshmërisë;

d) hartimin e kushteve dhe standardeve teknike në lidhje me krijimin e GIS kombëtar dhe GIS;

dh) hartimin e rregullave në lidhje me aksesin dhe shkëmbimin e informacionit gjeohapësinor nga subjektet publike dhe private;

e) çdo detyrë të veçantë të caktuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut.

KREU III
FUNKSIONIMI I AUTORITETIT SHTETËROR PËR INFORMACIONIN GJEOHAPËSINOR

Neni 11
Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacioni shoqërues

1. Autoritetet publike në kuadër të përgjegjësive të përcaktuara nga ligji për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor paraqesin pranë ASIG-ut, kërkesën ose propozimin për vlerësimin e çdo veprimi apo nisme në fushën e infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor.

2. Kërkesa ose propozimi i paraqitur sipas paragrafit 1 të këtij neni, përmban të dhëna teknike dhe financiare të plota, si dhe shoqërohet nga një relacion shpjegues, së bashku me dokumentacionin teknik dhe financiar përkatës, sipas rastit, në varësi të objektit, qëllimit dhe përmbajtjes së saj.

3. Dokumentacioni i mbërritur pranë ASIG-ut regjistrohet në regjistrin e korrespondencës nga struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit dhe i përcillet menjëherë Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG-ut.

4. Drejtori i Përgjithshëm përcjell brenda 24 orëve dokumentacionin e plotë pranë drejtorive, të cilat në varësi të objektit të punës së tyre, shprehen brenda 48 orëve, me një relacion të përbashkët mbi objektin e kërkesës. Në përfundim të procesit të shqyrtimit, drejtoritë i propozojnë Drejtorit të ASIG-ut:

a) miratimin e materialit të paraqitur dhe përcjelljen për mendim pranë BIG-ut;

b) kthimin e materialit për plotësimin e tij, në rast se të dhënat janë të pasakta ose jo të plota.

5. Kur autoriteti publik plotëson rekomandimet sipas shkronjës “b” të paragrafit të mësipërm dhe brenda 10 ditëve dhe paraqet sërish kërkesën për vlerësim, shqyrtimi i kësaj kërkese i nënshtrohet së njëjtës procedurë të parashikuar nga ky nen.

6. Kur drejtoritë i propozojnë drejtorit të ASIG-ut miratimin e materialit të paraqitur dhe përcjelljen për mendim pranë BIG-ut, drejtori autorizon sekretariatin teknik të ndjekë procedurat përkatëse për përcjelljen e kërkesës ose propozimit për mendim pranë BIG-ut.

Neni 12
Sekretariati Teknik i BIG-ut

1. Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe politikat ushtron gjithashtu detyrat e sekretariatit teknik të bordit të informacionit gjeohapësinor.

2. Sekretariati Teknik vepron në përputhje me rregullat e përcaktuara nga ligji mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij.

Neni 13
Veprimet e sekretariatit teknik

1. Sekretariati teknik ndihmon BIG-un në ushtrimin e veprimtarisë së tij:

a) duke krijuar kushtet e nevojshme për realizimin dhe mbarëvajtjen e mbledhjes;

b) duke përgatitur dokumentacionin e nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes;

c) duke përcjellë njoftime për anëtarët e BIG-ut, kur kjo kërkohet nga kryetari i BIG-ut;

d) duke kryer çdo detyrë tjetër në kuadër të asistencës për BIG-un në lidhje me çështje që përfshihen në fushën e veprimtarisë së tij.

2. Struktura përgjegjëse për koordinimin dhe politikat në cilësinë e sekretariatit teknik të BIG-ut, menjëherë pas marrjes së autorizimit, sipas pikës 6 të nenit 15, fillon punën për përgatitjen e një dosjeje të plotë me materialet që i bashkëlidhen kërkesës, për të gjithë anëtarët e BIG-ut.

3. Dosja sipas përcaktimeve të paragrafit 2 të këtij neni, përgatitet brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës dhe i përcillet menjëherë kryetarit të BIG-ut.

4. Sekretariati teknik është përgjegjës për njoftimin me shkrim të të gjithë anëtarëve të BIG-ut. Njoftimi dërgohet zyrtarisht në rrugë shkresore ose elektronike. Njoftimet për thirrjen e mbledhjeve bëhen të paktën 15 ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes.

5. Njoftimi për thirrjen e një mbledhjeje duhet të përcaktojë datën, vendin dhe orën e zhvillimit të saj, si dhe të tregojë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet. Në njoftimin për mbledhjen e BIG-ut, anëtarëve u bashkëlidhen materialet e plota të çështjeve që do të diskutohen në mbledhje.

6. Sekretariati teknik njofton anëtarët e BIG-ut të paktën 3 ditë përpara, për çdo ndryshim në datën dhe kohën e vendosur për mbledhjet.

7. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve të BIG-ut, njëri nga punonjësit e sekretariatit teknik ngarkohet nga kryetari me detyrën e sekretarit të mbledhjes dhe mban procesverbalin e saj. Procesverbali duhet t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve, brenda 2 (dy) ditëve nga përfundimi i mbledhjes.

8. Çdo anëtar i BIG-ut, pasi verifikon përmbajtjen e procesverbalit të mbledhjes, ka të drejtë të paraqesë kundërshtime përpara mbledhjes pasardhëse. Këto kundërshtime i paraqiten me shkrim, në rrugë shkresore ose elektronike kryetarit të BIG-ut, i cili, me ndihmën e sekretariatit teknik, kujdeset për t'ia bërë ato të ditura anëtarëve të tjerë.

Neni 14
Arkivimi i dokumentacionit

Sekretariati teknik administron dhe arkivon të gjithë dokumentacionin në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

Neni 15
Rekomandimi i ASIG-ut

1. ASIG, pasi merr mendimin e BIG-ut, merr vendim të argumentuar mbi çdo veprim apo nismë në fushën e infrastrukturës së informacionit gjeohapësinor, sipas nenit 21 të ligjit mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.

2. Rekomandimi i ASIG-ut i përcillet me shkrim autoriteteve publike përgjegjëse, brenda 10 ditëve, nga dita e dhënies së mendimit nga BIG-u.

KREU IV
MARRËDHËNIET E PUNËS SË PUNONJËSVE TË ASIG-UT

Neni 16
Punonjësit e ASIG-ut

Marrëdhëniet e punës së punonjësve të ASIG-ut rregullohen sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", të ndryshuar.

Neni 17
Kërkesat për pranim

1. Punonjës i ASIG-ut mund të zgjidhen personat, të cilët plotësojnë këto kërkesa të përgjithshme:

a) të jenë shtetas shqiptarë;

b) të kenë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të përmbushin kërkesat specifike për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;

ç) të jenë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse;

d) të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi.

Neni 18
Procedura e pranimit

1. Pranimi kryhet nëpërmjet konkurrimit të hapur, bazuar në meritat.

2. Shpallja e konkurrimit bëhet nga Drejtori i Përgjithshëm, bazuar në nevojat e ASIG-ut.

3. Shpallja botohet në dy gazetat me qarkullim më të madh të paktën 30 ditë para datës së caktuar për konkurrim.

4. Shpallja për konkurrim përmban një listë të kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët dhe të fushave në të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

5. Konkurrimi zhvillohet në tri faza:

a) Në fazën e parë bëhet përzgjedhja e kandidatëve për t'iu nënshtruar testimit dhe konsiston në verifikim nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa do të pranohen për t'iu nënshtruar fazës së testimit.

b) Në fazën e dytë zhvillohet testimi. Për zhvillimin e kësaj faze, krijohen komitete të veçanta ad-hoc. Këto komitete përbëhen prej tre anëtarësh me një përfaqësues të burimeve njerëzore dhe dy përfaqësues të strukturës në të cilën është shpallur pozicioni i lirë. Komiteti ad-hoc do të hartojë një listë me tre kandidatët me rezultatet më të larta, duke u bazuar kryesisht në rezultatet e testimeve, por edhe në kualifikimet, përvojën profesionale dhe aftësitë e veçanta të kandidatëve. Rezultatet e testimeve do të përbëjnë 70 për qind të pikëve totale të vlerësimit, ndërsa kualifikimet, përvoja profesionale dhe aftësitë e veçanta të kandidatëve do të përbëjnë 30 për qind të pikëve.

c) Në fazën e tretë bëhet vlerësimi përfundimtar i kandidatëve. Në këtë fazë, Drejtori i Përgjithshëm ASIG zgjedh një nga tre kandidatët e propozuar nga komitetet ad-hoc.

6. Marrëdhëniet juridike të punonjësve të ASIG-ut fillojnë me aktin e emërimit të tyre dhe janë pa afat. Akti i emërimit për punonjësit e ASIG-ut nënshkruhet nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut.

Neni 19
Rregullat e etikës së punonjësve

Rregullat dhe parimet e përgjithshme të etikës, konflikti i interesave, veprimtaria e jashtme, përfitimet, si dhe detyrimet e tjera gjatë dhe pas periudhës së punësimit, të parashikuara për nëpunësin civil me legjislacionin për rregullat e etikës në administratën publike, si dhe për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike, zbatohen edhe për punonjësit e ASIG-ut.

Neni 20
Masat disiplinore

1. Punonjësit të ASIG-ut i jepen masa disiplinore për mosplotësimin e detyrave funksionale, për thyerjen e disiplinës në punë dhe të rregullave të etikës, si dhe në raste të tjera të parashikuara nga kjo rregullore.

2. Masat disiplinore jepen nga Drejtori i Përgjithshëm ASIG, me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë ose edhe kryesisht.

3. Për çdo shkelje jepet vetëm një masë disiplinore.

4. Masa disiplinore quhet e përshtatshme, vetëm nëse është në përputhje me shkeljen disiplinore. Në përcaktimin e masave disiplinore merren parasysh shkaqet dhe rëndësia e shkeljes disiplinore, shkalla e fajësisë, rrethanat në të cilat është kryer shkelja, pasojat e shkeljes, sjellja e përgjithshme në kryerjen e detyrave të ngarkuara, si dhe fakti nëse punonjësi ka marrë apo jo masa disiplinore të mëparshme.

Neni 21
Llojet e masave disiplinore

1. Llojet e masave disiplinore që merren ndaj punonjësit të ASIG-ut janë:

a) vërejtje me shkrim;

b) vërejtje me paralajmërim;

c) pezullim i përkohshëm i ushtrimit të detyrave funksionale, për një periudhë deri në 1 vit;

d) largim nga administrata e ASIG-ut.

2. Procedura për dhënien e masës disiplinore “Largim nga administrata e ASIG-ut”, bëhet në përputhje me parashikimet e legjislacionit të punës, për zgjidhjen e kontratës individuale të punës me afat të pacaktuar.

Neni 22
Ecuria disiplinore

1. Ecuria disiplinore fillon me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë ose dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut kryesisht, për shkelje disiplinore të konstatuara.

2. Kërkesa duhet të plotësojë këto kushte:

a) Të jetë me shkrim;

b) Të identifikojë punonjësin, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore;

c) Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij.

3. Kur drejtori i përgjithshëm vendos fillimin e ecurisë disiplinore, njofton menjëherë punonjësin:

a) për të drejtën që ai ka, për të paraqitur me shkrim sqarimet e tij rreth shkeljes së pretenduar, afatin deri kur duhet të paraqitet ky sqarim;

b) për të drejtën që ai ka të dëgjohet, ai vetë apo me përfaqësues ligjor dhe për të paraqitur dëshmitarë;

c) për datën kur do të shqyrtohet shkelja e pretenduar. Kjo datë nuk mund të caktohet më vonë se 10 ditë, nga marrja e njoftimit.

4. Pasi shqyrton çështjen, dhe dëgjon punonjësin përkatës a përfaqësuesin ligjor apo vë në dukje me shkrim mosparaqitjen e tij, megjithëse nëpunësi ka marrë dijeni kundrejt konfirmimit, Drejtori i Përgjithshëm i ASIG vendos:

a) marrjen e një mase disiplinore, kur vëren se ka pasur shkelje disiplinore;

b) ndërprerjen e ecurisë disiplinore, në rast kur vëren se:
- nuk ka shkelje disiplinore, siç ishte menduar;
- veprimi i shqyrtuar nuk përbën shkelje;
- veprimi nuk ka qenë ose nuk është kryer nga nëpunësi përkatës.

KREU V
AKTET ADMINISTRATIVE, HARTIMI DHE QARKULLIMI

Neni 23
Aktet administrative dhe aktet e tjera

1. Llojet e akteve administrative të pranishme në veprimtarinë ekzekutive dhe urdhërdhënëse të ASIG-ut janë:
a) urdhri;
b) vendimi.
2. Këto akte duhet të përmbajnë elementet e domosdoshme dhe të përmbushin kërkesat për aktin administrativ, të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.
3. Përveç elementeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, aktet administrative mund të përmbajnë sipas rastit edhe elemente të tjera të përcaktuara në ligjin mbi infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor.
4. Përveç akteve administrative, në veprimtarinë ekzekutive dhe urdhërdhënëse të ASIG-ut përdoren edhe memot dhe kartelat shoqëruese të materialeve.
5. Aktet administrative dhe aktet e tjera të përshkruara në këtë nen, hartohen sipas modeleve të caktuara me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të ASIG-ut.

Neni 24
Hartimi i dokumenteve

1. Dokumentet që hartohen nga ASIG-u, adresuar institucioneve të tjera, duhet të kenë në krye figurën e stemës së Republikës, poshtë saj shkrimin “Republika e Shqipërisë”, nën këtë të fundit “Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit” dhe poshtë saj “Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”.
2. Shkresat duhet të përmbajnë tekstin e dokumentit, funksionin, emrin, mbiemrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij. Vula, data dhe numri i protokollit vendosen pas firmosjes nga Drejtori i Përgjithshëm i ASIG-ut.
3. Të gjitha shkresat që hartohen nga strukturat e ASIG-ut, duhet të kenë këta parametra:
a) Shkrimi *Times New Roman*, madhësia 12;
b) Hapësirat e shkresës nga të dyja anët e shkresës është 2.5 cm ose 1 inch;
c) Koka e shkresës shkruhet me shkronja kapitale dhe *bold*;
d) Data dhe numri i protokollit vendosen me një distancë prej dy hapësirash nga koka e shkresës. Data vendoset në anë të majtë ndërsa numri i protokollit në të njëjtin rresht me datën, në anën e djathtë.
4. Ekzemplari i dokumentit që mbahet në sektorin e arkiv-protokollit dhe trajtohet nga strukturat e ASIG-ut, siglohet sipas rastit nga përpiluesi, përgjegjësi i sektorit, si dhe drejtori i drejtorisë.
5. Në mungesë të drejtorit të ASIG-ut, aktet zyrtare mund të firmosen nga personat e autorizuar me shkrim prej tij. Në këtë rast në aktin zyrtar vihet shënim: “Në mungesë dhe me porosi”.

Neni 25
Dokumentet administrative që vijnë në adresë të ASIG-ut

1. Dokumentet hyrëse regjistrohen në regjistrin e korrespondencës nga sektori i arkiv-protokollit, i cili bën shënimin në to të numrit dhe datës së marrjes. Dokumentet i përcillen drejtorit të ASIG-ut ose personit të autorizuar me shkrim prej tij, i cili brenda 24 orëve bën shpërndarjen e tyre sipas përkatësisë në strukturat që kanë lidhje me problematikën e tij, kundrejt firmës.

2. Brenda afatit të përcaktuar në kartelë, materiali pasi është sigluar nga përpiluesi, përgjegjësi i sektorit, drejtori i drejtorisë, dorëzohet pranë drejtorit të përgjithshëm.

3. Pas nënshkrimit materiali evidentohet në kartelë, i cili i dorëzohet kundrejt firmës strukturës së arkiv-protokollit.

Neni 26
Komunikimi midis strukturave të ASIG-ut

1. Materialit që trajtohen nga strukturat e ASIG-ut, në kuadrin e marrëdhënieve të brendshme të bashkëpunimit midis tyre, evidentohen në protokollin e brendshëm të ASIG-ut.

2. Praktikat e brendshme shoqërohen nga një kartelë e brendshme, e cila përmban këto elemente:

a) strukturën nga vjen;

b) lëndën objekt të materialit;

c) drejtorinë;

ç) afatin e trajtimit të materialit.

3. Këto dokumente ruhen në strukturat përkatëse të ASIG-ut, si dhe nga sektori i arkiv-protokollit dhe pasi humbasin vlerën e ruajtjes nxirren për asgjësim, sipas rregullave në fuqi nga vetë strukturat e ASIG-ut ose struktura përgjegjëse e arkiv-protokollit.

VENDIM
Nr. 150, datë 27.2.2013

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË ORGANIKËS SË ADMINISTRATËS SË AKADEMISË SË SHKENCAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, gjithsej 29 veta, sipas lidhjeve që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 399, datë 26.5.2010 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së administratës së Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Organigrama e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



STRUKTURA ORGANIZATIVE E AKADEMISË SË SHKENCAVE TË RSH

Emërtimi i Funksionit	Nr. punonjësve	Kategoria/klasa
1. Kryesia	**4**	
- Kryetar	1	
- Zëvendëskryetar	1	
- Sekretar Shkencor	1	
- Specialist për Komunikimet Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë dhe me Publikun	1	IV-a
2. Seksionet Shkencore	**8**	
- *Seksioni i Shkencave Shoqërore Albanologjike*		
- Kryetar Seksioni (akademik/akademik i asociuar)	1	
- Sekretar Shkencor i Seksionit (professor)	1	
- Asistent i Seksionit - Specialist	1	IV-a
- Redaktor shkencor i revistës "Studia Albanica"	1	III-b
- *Seksioni i Shkencave Natyrore Teknike*		
- Kryetar Seksioni (akademik/akademik i asociuar)	1	
- Sekretar Shkencor i Seksionit (profesor)	1	
- Asistent i Seksionit – Specialist	1	IV-a
- Redaktor Shkencor i revistës "Albania Journal Natyral and Technical Sciences"	1	III-b
3. Njësia e Projekteve të Kërkimit dhe Zhvillimit, Teknologjive dhe Inovacioneve	**1**	
- Punonjës shkencor për projektet (profesor)	1	
4. Sektori i Botimeve Shkencore dhe Bibliotekës Shkencore	**6**	
- Përgjegjës sektori (me gradë shkencore)	1	III-a/1
- Redaktor i veprave të rëndësishme shkencore: Monografi, Traktate, Studime	1	III-b
- Ndihmës specialist/Editor	1	VIII
- Bibliografe	1	IV-a
- Bibliotekare	1	VIII
- Punonjëse shërbimi	1	I
5. Sektori i Financës	**4**	
- Përgjegjës sektori	1	III-b
- Specialist finance	1	IV-a
- Specialist për ndjekjen dhe shpërndarjen e botimeve	1	IV-b

- Magazinier	1	VI
6. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve	**6**	
- Përgjegjës sektori + Sekretare e Kryesisë	1	III-b
- Specialist - ICT	1	IV-a
- Protokoll – Arkivist	1	VII
- Teknik mirëmbajtës	1	III
- Shofer	1	IV
- Punonjëse shërbimi	1	I
GJITHSEJ NUMRI I PUNONJËSVE	**29**	

VENDIM
Nr. 152, datë 27.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "SHËNGJON" DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja "b", të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Shëngjon" është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë "Edi Energy", sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Shëngjon", duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 153, datë 27.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "KRYEZI 3" DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja "b", të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Kryezi 3" është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë "Oberaldi" sh.p.k.
3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Kryezi 3", duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.
4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 154, datë 27.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "BALLENJË" DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 e 23, pika 3 shkronja "b", të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit "Ballenjë" është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.
2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë "Ballenja Kompani", sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Ballenjë", duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 157, datë 27.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË SHËRBIMIT TË MONITORIMIT DHE FISKALIZIMIT TË LOJËRAVE TË FATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2 e 5, pika 3, të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurës ligjore për dhënien me koncesion të shërbimit të monitorimit dhe fiskalizimit të lojërave të fatit është Ministria e Financave.

2. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 159, datë 27.2.2013

PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË KRYETARIT TË KOMUNËS DARDHAS, Z. ALEKSANDËR ÇELA

Në mbështetje të neneve 100 e 115, pika 1, të Kushtetutës, dhe të shkronjës "b" të nenit 42 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkarkimin nga detyra, për shkak të kryerjes së veprës penale, të kryetarit të komunës Dardhas, z. Aleksandër Çela.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 162, datë 27.2.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË SHTETASES MANUSHAQE STANA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri "Mallra dhe shërbime", t'i shtohet fondi prej 870 000 (tetëqind e shtatëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të shtetases Manushaqe Stana.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 163, datë 27.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHTESË NË VENDIMIN NR. 396, DATË 31.3.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E KUFIJVE DHE RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE TË SHKODRËS, LEZHËS, APOLONISË, BYLISIT, AMANTIAS, ORIKUMIT, ANTIGONESË, FINIQIT DHE BUTRINTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të neneve 29 pika 2, e 53 pika 2 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren e administrimit të parqeve arkeologjike, miratuar me vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në shkronjën "b" të pikës 3 dhe në pikën 11 të rregullores, hiqen fjalët "… Amantias, Orikumit …".

b) Pas shkronjës "c" të pikës 3 të rregullores shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum, sipas kësaj rregulloreje, është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtarë Vlorë.".

2. Ngarkohen Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum të dorëzojë të gjithë dokumentacionin ligjor pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 55, datë 20.2.2013

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR "CLUB FM"

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat "CLUB FM", në fushën e transmetimeve radiofonike private, vendore.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2012 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë BUSHATI

VENDIM
Nr. 56, datë 20.2.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË PERSONIT FIZIK GAZMEND VOGLI, LICENCUAR PËR SUBJEKTIN TELEVIZIV PRIVAT VENDOR "TV KLAUDIANA"

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Gent Ibrahimi	anëtar
Suela Musta	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar,

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

KËRKUES: Subjekti televiziv privat vendor "TV Klaudiana".

OBJEKT: Shqyrtim i kërkesës së subjektit televiziv privat vendor "TV Klaudiana".

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22 e 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VËREN SE:

KKRT, me vendimin nr. 22/01, datë 23.10.2000, ka licencuar subjektin, person fizik Gazmend Vogli, për televizionin privat vendor "TV Klaudiana". Me vendimet nr. 385, datë 30.11.2005 dhe nr. 66, datë 11.2.2011, KKRT ka rinovuar licencën e këtij subjekti.

Me shkresën e datës 28.1.2013, nr. 163 prot., ky subjekt ka paraqitur pranë KKRT-së njoftimin për disa ndryshime të ndodhura në këtë subjekt, duke kërkuar miratimin e tyre nga ana e Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit.

Më konkretisht, subjekti njofton se në datën 25.2.2011, për shkak të angazhimeve të tij profesionale në institucionet shtetërore, ia ka kaluar të drejtat e licencës së "TV Klaudiana", bashkëshortes së tij.

Subjekti, përveç kërkesës, ka paraqitur edhe dokumentacionin zyrtar që vërteton ndryshimet e kryera. Kështu, subjekti ka paraqitur ekstraktin e regjistrit tregtar të datës 23.1.2013, nga i cili rezulton se në datën 8.2.2011, është regjistruar personi fizik në emër të Edlira Vogli, fusha e veprimtarisë së subjektit është: "Veprimtari radiotelevizioni".

Po ashtu, subjekti ka depozituar kopje të certifikatës së çregjistrimit të subjektit person fizik Gazmend Vogli.

Lidhur me ndryshimet e ndodhura në këtë subjekt, KKRT vëren se, mbështetur në nenin 22 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, licenca e transmetimit është e patjetërsueshme dhe vlen vetëm për subjektin të cilit i është dhënë. Në rast se mbajtësi i licencës hyn në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave është edhe veprimtaria radiotelevizive e licencuar, atëherë për cedimin ose kalimin e të drejtave që burojnë nga licenca kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Subjektit që ka fituar këto të drejta, miratimi i jepet në formën e një licence të re me të njëjtën përmbajtje. Kur Këshilli nuk e miraton kalimin për shkaqe të parashikuara në këtë ligj, i ofron frekuencat që i përkasin kësaj licence për një konkurrim të ri kandidaturash.

Në rastin konkret, rezulton se subjekti i pajisur me licencë nga KKRT, ka kaluar të drejtat që burojnë nga licenca në një subjekt tjetër tregtar, i regjistruar në formën e subjektit person fizik Edlira Vogli.

Njoftimi i subjektit është bërë jashtë afatit të parashikuar në nenin 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, sipas të cilit: "I licencuari detyrohet të njoftojë Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit për çdo ndryshim të të dhënave që ka paraqitur në kërkesën për marrjen e licencës ose për mosplotësimin e kushteve të caktuara në licencë, duke dhënë dhe arsyet përkatëse, paraprakisht dhe në çdo rast, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve …"

KKRT e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e subjektit.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22 e 30 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga subjekti person fizik Gazmend Vogli, licencuar për subjektin televiziv privat vendor "TV Klaudiana", duke vendosur:

a) T'i heqë subjektit person fizik Gazmend Vogli, licencën me nr. 001/TVL të televizionit privat vendor "TV Klaudiana";

b) Të kalojë licencën nr. 001/TVL të televizionit privat vendor "TV Klaudiana", subjektit person fizik Edlira Vogli.

2. Ngarkohet administrata e KKRT-së për veprime të mëtejshme.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë BUSHATI

KËRKESË

Shtetasi Kadri Halluni, i biri i Zijasë dhe Nadires, i datëlindjes 19.10.1941, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë deklarimin e vërtetimit të faktit juridik të vdekjes për shtetasit Hajredin Hallulli.

KËRKUES
Kadri Hallulli

KËRKESË

Shtetasi Landi (Taulant) Hazizaj, i biri i Resulit dhe i Zyrasë, i datëlindjes 19.3.1981, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të zhdukur të shtetases Tatjana Hazizaj.

KËRKUESI
Landi (Taulant) Hazizaj

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 18.3.2013
Doli nga shtypi më 18.3.2013

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 46 lekë